

VENDIM
Nr. 45, datë 12.4.2016

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË “EVN TRADING” SHPK, PËR HEQJEN E
LICENCËS PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME
NR. 179, SERIA T12, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 124, DATË 29.8.2012, TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s**

Në mbështetje të neneve 16; 39, pika 1 dhe 42 pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 121/1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 5.1, germa “a”, të Licencës për Tregtim T12; nenit 5 të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.3.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve për heqjen e licencës së shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 179, seria T12, miratuar me vendimin nr. 124, datë 29.8.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria “EVN Trading” sh.p.k., me shkresën nr. 28 prot., datë 6.1.2016, ka paraqitur në ERE një kërkesë për heqjen e licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 179, seri T12, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124, datë 29.8.2012.

- Me vendimin nr. 14, datë 16.2.2016, ERE vendosi fillimin e procedurave për heqjen e licencës me nr. 179 dhe numër serie T12 të shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k.

- Shoqëria “EVN Trading” sh.p.k., ka shlyer çdo detyrim financiar ndaj ERE-s, siç është parashikuar në kushtet e licencës.

- Shoqëria “EVN Trading” sh.p.k., nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitetin për të cilin është licencuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “EVN Trading” sh.p.k., për heqjen e licencës me nr. 179 dhe numër serie T12.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 124, datë 29.8.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “EVN Trading” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s dhe Drejtoria e Çmimeve dhe e Tarifave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti